



PAKO E GARANCIONIT STANDARD PËR SISTEME FISKALE

ÇKA PËRFSHIHET NË PAKO:

Me shërbimin “Garacion Standard” nënkuptohen shërbimet, intervenimet dhe riparimet si ne vijim:

<ul style="list-style-type: none">● Asistenca telefonike: Përfshihen të gjitha thirrjet e kryera/pranuara nga tekniku i autorizuar kundrejt pikës që ka defekt dhe kërkon asistencë dhe gadishmerinë e përgjigjes në thirrje.
<ul style="list-style-type: none">● Asistencën në piken e instalimit të sistemit: të gjitha ndërhyrjet në pikën ku është i instaluar sistemi fiskal si: kontrollim e funksionimit, hapje dhe ribllombim, resetim i pajisjes fiskale dhe rikthim i informacionit, rikonfigurim i databazes dhe sistemit operativ ne rast te korrupimit, rikonfigurim i kanaleve te komunikimit, kontrollim i lidhjeve-kabllove te komunikimit dispenser-sistem fiskal dhe kabllot sistem fiskal-printer fiskal si dhe kontrollimin e komunikimit me serverin e ATK-se.
<ul style="list-style-type: none">● Regjistrimi i nënartikujve të ri dhe modifikimi i ekzistuesve: sipas kërkesave të klientit në varësi të artikujve që ai shet dhe përcaktimeve të ATK-se.
<ul style="list-style-type: none">● Azhurimet e firmuerit të printerit dhe KDE, me versionet e fundit zyrtare, paraprakisht të certifikuar te organi kompetent.
<ul style="list-style-type: none">● Rifiskalizimi i pajisjes: Siq janë: numri i telefonit apo adresa, ndërrime qe nuk kanë te bejnë me ndërrimin e memories fiskale dhe plotësimin e informatave ne sistemin informativ te ATK-së.
<ul style="list-style-type: none">● Rikonfigurim i sistemit fiskal, ne rast të humbjes se konfigurimit për ndonjë arsye, ri-caktim i kanaleve te komunikimit dhe realizim i komunikimit te suksesshem Dispenserë – Sistem Fiskal.
<ul style="list-style-type: none">● Rikonfigurim, azhurim dhe ri-instalim i fajllit per eksport

Koha e intervenimit: në ditët e javës nga e Hëna deri të Premten prej orës 08:00 deri në orën 17:00 dhe ditën e shtunë prej orës 08:00 deri në orën 15:00. Asistenca teknike do të ofrohet brenda 72 orësh, nga momenti i njoftimit prej “Blerësit” për nevojën për intervenim në kuadër të shërbimit në fjalë, njoftim me shkrim apo telefon.

ÇMIMI I KONTRATËS:

“Shitësi” i ofron “Blerësit” shërbimin “Garacion Standard” për çmimin në vlerë prej 75.00 euro me TVSH per nje dispenser te instaluar ne pompen e “Blerësit”.

NË ÇMIMIN E KONTRATËS NUK PËRFSHIHEN:

1. MF (memoria fiskale) dhe EJ-SD kartela jane material konsumi.
2. **Dëmtimet e shkaktuara** nga kushtet atmosferike, keqpërdorimi i sistemit fiskal, demtimi fizik, ndërhyrjet e paautorizuara, heqje apo demtim të bllobes, nuk përfshihen edhe demtimet nga forcat madhore, embargo, revolucion, bllokade, greva, nderhyrje ushtarake, apo prishje te rendit kushtetues, termeti, stuhite, permbytjet, epidemite, apo ndonje katastrofe tjeter natyrore.